

SHTOHEN OREKSET E GREKËVE: NGA VORIO EPIRI TEK EPIRI

Që nga krijimi i shtetit grek e deri më sot, qarqet politike të Athinës politikën e tyre ndaj Shqipërisë e kanë ndërtuar mbi bazën e programit të “Megali Idesë” të kryeministrit J. Koleti. Nga ky program është udhëhequr veprimtaria e bandave greke para Kongresit të Berlinit; në të janë mbështetur mëtimet territoriale të Greqisë dhe shpërblimi i saj me troje shqiptare nga Kongresi i Berlinit, pushtimi i tokave shqiptare gjatë Luftërave Ballkanike, shkëmbimi i popullsisë shqiptare të trojeve të pushtuara me turq ortodoksë, pushtimi i dytë gjatë Luftës Italo-Greke më 1941, masakrat në Çamëri e dëbimi i çamëve nga trojet e tyre. Edhe sot e gjithë ditën, Greqia, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë ekonomike të Shqipërisë pas rënies së diktaturës dhe duke përdorur si peng gjysmë milion emigrantë, po bën ç’është e mundur për përmbushjen e qëllimeve të saj ndaj Shqipërisë së Jugut, që grekët e quajnë Epir.

Synimet aneksioniste të Greqisë ndaj Shqipërisë janë intensifikuar sidomos që nga fillimi i viteve ‘90. Fare hapur politikanët grekë e kanë bërë të qartë se rruga e Shqipërisë për në Bashkimin Europian kalon nga Athina. Dhe Athina portat e BE-së mendon të na i hapë vetëm pasi të ketë përmbushur planet e saj: të ketë krijuar, së pari, parlamentin e Vorio Epirit; të ketë bërë regjistrimin e popullsisë në Shqipëri me deklaram të përkatësisë etnike, gjatë të cilit ajo pjesë e popullsisë e pajisur me dokumentin e vorio-epirotit, apo kartën e homogjenit, do të deklarohet greke. Pastaj, parlamenti vorio-epirot, dmth. një grup grekësh të vetëshpallur si epirotë ose shqiptarësh renegatë, do të shpallin autonominë e Vorio Epirit.

Por në këtë parashikim bëmë një gabim, sepse tashmë orekset janë hapur. Politika greke sot flet për Epirin. Dhe nuk e gjejmë këtë në ndonjë faqe interneti të qarqeve ultranacionaliste greke apo në gazeta, por të nyjëtuar nga vetë kreu i shteti grek, zoti Papulias. Ditë më parë, në takimin e përvitshëm të Federatës Pan-Epirote Greke, ku ishte i ftuar nderi, presidenti grek nuk ka folur për Vorio Epirin, siç është bërë deri tani në propagandën greke, po për Epirin, “të njohur me këtë emër që nga lashtësia e hershme” dhe për “komunitetin grek të Shqipërisë së Jugut, të identifikuar si epirotë”. E zeza mbi të bardhë: presidenti grek na thotë se popullsia e Epirit është greke.

Greqia i ka vënë në punë të gjitha mjetet e propagandës dhe gjithë mekanizmat në shërbim të politikës së saj aneksioniste, nga kisha te biznesi, duke punuar në sinkron edhe me të gjitha organizatat nacionaliste greke. Në ndihmë të kësaj politike është si gjithnjë edhe shkenca historike greke, e cila fsheh, shtrembëron e manipulon faktet historike për të mbështetur mëtimet territoriale të Greqisë ndaj fqinjëve të saj.

Po cila është e vërteta për Epirin dhe Vorio Epirin? Cili është ndryshimi mes dijetarëve seriozë, nga njëra anë, dhe grekëve, nga ana tjetër, për këtë çështje? Për këtë le t’i drejtohem historisë.

Fjala “Epir” (*apeiros*) në dialektin dorik (të greqishtes së vjetër) kishte kuptimin “tokë, stere, kontinent” dhe përdorej prej banorëve të ishujve grekë të Jonit ose prej lundëtarëve grekë për brigjet përballë. Më vonë, ky emër i përgjithshëm u shndërrua në një emërtim gjeografik për krahinat përballë Korfuzit dhe pastaj për të shënuar atë pjesë të Ilirisë që shtrihej midis Vjosës në veri e verilindje dhe gjirit të Ambrakisë (të Artës) në jug dhe mes maleve të Pindit në lindje e Jonit dhe Adriatikut në perëndim. Në gjysmën e dytë të shek. V, fiset që banonin në këtë trevë Helaniku i quajti *Epeirotae*; më 427-426 p.K., një mercenar, në një dedikim që i bën në Lakoni perëndisë Poseidon, e quan veten *Apeirotas*. Kjo do të thotë se që nga ajo kohë fiset ilire të Epirit thirreshin *epirotë*.

Shkenca historike i njeh epirotët si degëzimin jugor të ilirëve. Që fiset epirote nuk ishin greke, për këtë dëshmitë na vijnë nga dijetarët më të vjetër dhe më në zë të Greqisë: Herodoti, Tuqididi, Efori, Straboni, Ptolemeu etj.

Babai i historisë, Herodoti, kur flet për forcat greke që morën pjesë në betejën e Salaminës kundër persëve (480 para Krishtit), thotë: «Të gjitha qytetet, kontigjentet e të cilave morën pjesë në këtë luftë, banojnë këndej Thesprotisë dhe lumit Akeron; thesprotët, në të vërtetë, janë në kufi me Ambrakinë dhe Leukadën, që ishin, pra, qytetet më të largëta (të Greqisë–R.M.) ndër ato që morën pjesë në luftë.» (Le storie, 1997, p. 743).

Tuqididi fiset e Epirit që morën pjesë në Luftën e Peloponezit (431–404) përkrah Spartës, si aleatë të ambrakasve, i quan barbarë. Në dy librat e tij ka disa pasazhe ku flet për këto fise. Kështu, kur përshkruan betejën detare midis koryrasve dhe korintasve që u zhvillua në një port të Thesprotisë, thotë se “me korintasit ishin në kontinent shumë barbarë, që kishin ardhur në ndihmë të tyre; banorët e kësaj pjese të kontinentit ishin gjithnjë miq të tyre” (Le storie, I, 1982, 46.1). Dhe kur Lufta e Peloponezit kishte filluar, ai shkruan se në verën e vitit 429 “ambrakasit dhe kaonët, duke dashur të nënshtonin gjithë Akarnaninë për ta bërë të hiqte dorë nga aleanca me Athinën”, ndërmorën kundër saj një fushatë, në krye të së cilës u vu spartani Knem. “Me Knemin, – shkruan Tuqididi, – ishin nga grekët ambrakasit, leukadasit, anaktorasit dhe një mijë spartanë; dhe, nga barbarët, një mijë kaonë... Bashkë me kaonët ishin edhe tesprotët”, molosët, atintanët, parauejtë, orestët dhe një mijë maqedonë (Le storie, II, 1982, 80.1). Në marshimin kundër qytetit Strato të Akarnanisë «kaonët dhe barbarët e tjerë ishin vendosur në qendër të ushtrisë», kurse në të majtë dhe të djathtë të tyre ishin grekët: në njërin krah leukadasit e anaktorasit, në krahun tjetër, nën komandën e Knemit, lakedemonët, peloponezasit dhe ambrakasit.” (Le storie, II, 81.1)

Sipas Strabonit, Efori (autor grek i shek IV p.K.) thotë se, «po të nisim nga pjesët perëndimore, Akarnania është fillimi i Greqisë; sepse Akarnania është e para që kufizohet me fiset epirote» (Strabo, Geography, libri 8.I.3)

Vetë Straboni (63 p. K.– 21 e.r.) shkruan se “pas epirotëve dhe ilirëve vijnë popujt e mëposhtëm të grekëve: akarnanianët, etolianët dhe lokrianët ozolianë” (Geography, 8.I(1)). Sipas tij, kufiri jugor midis fiseve epirote dhe grekëve ishte gjiri i Ambrakisë, me Amfilokët si fisi më jugor i Epirit. “Ajo pjesë e vendit që është në të djathtë të gjirit kur lundron në të, – shkruan ai, – banohet nga grekët akarnanianë” (7.VII.6). Dhe më poshtë: “amfilokët janë epirotë dhe kështu janë edhe popujt sipër tyre”, molosët, atamanët, etikët, tymfejtë, orestët etj. (7.VII.8).

Lidhur me përkatësinë etnike të tyre, edhe Straboni i quan epirotët barbarë: “Madje edhe sot trakët, ilirët dhe epirotët jetojnë në krah të grekëve ...; me të vërtetë, pjesa më e madhe e vendit që sot është pa dyshim Greqi banohet nga barbarët – maqedonët dhe disa pjesë të Thesalisë prej trakëve dhe pjesët mbi Akarnaninë e Etolinë prej thesprotëve, kasiopëve, amfilokëve, molosëve dhe atamanëve, fise epirote.” (7.VII.1)

Ptolemeu (shek I–II e.r.) kufirin lindor dhe jugor të Epirit e shtyn madje edhe më në lindje dhe më në jug, duke marrë si vijë ndarëse rrjedhën e lumit Achelou (Aspropotam) (Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë, TOENA, 2002, f. 269).

Duket se përbërja etnike dhe shtrirja e Epirit kishte mbetur po ajo edhe në shek. VI të erës sonë, siç del nga “Fjalori gjeografik” i Stefan Bizantinit, i cili atamanët, që zinin skajin më jugor të Epirit, i quan ilirë (Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë, f. 416).

Për të ardhur në kohët më të reja, në një dokument venedikas të vitit 1210 thuhet se kontinenti përballë Korfuzit banohej nga shqiptarët (*arbanenses*) (P. Xhufi, St. hist., 1995, nr. 1-4, f. 11). Kjo dëshmon se të paktën qysh nga kjo kohë viset në jug të Akrokerauneve e deri në Gjirin e Artës qenë përfshirë nën emërtimin etnogjeografik “Arbëri” (Albania), që dalëngadalë zëvendësoi emërtimet e vjetra thjesht gjeografike apo politiko-administrative, si Epir etj. Kështu, në një dokument tjetër venedikas të vitit 1395 thuhet se në krahun tjetër të detit që ndan ishullin e Santa Maurës nga toka, «është Arbëria (Albania), provincë e madhe, që sundohet nga despoti i Artës» (St. hist., 1995, nr. 1-4, f. 13). Pra, shqiptarët e Shqipërisë së Jugut janë autoktonë në këto troje dhe pasardhës të drejtpërdrejtë të epirotëve të lashtësisë.

Grekët e sotëm i japin Epirit herë të njëjtën shtrirje si autorët e lashtë, here një shtrirje edhe më të madhe, por në të dyja rastet nuk pajtohen me të lashtët dhe as me historianët e kohëve të reja e moderne për sa i përket karakterit të tij etnik. Për historianët dhe politikanët grekë epirotët ishin helenë. Ky qëndrim i tyre zë fill me presidentin e parë të Greqisë Jan Kapodistrian, sipas të cilit “madhësia e Greqisë duhet matur duke ndjekur nga veriu vijën që fillon me grykëderdhjen e lumit të Vjosës”. Për të ardhur në ditët tona, po sjellim një përkufizim të Epirit nga uebsajti i Fondacionit të Studimeve për Epirin e Veriut me qendër në Janinë: “Që nga lashtësia Epiri, – shkruhet aty, – të cilin Aristoteli e quante “Greqia antike”, ka qenë historikisht, etnologjikisht dhe gjeografikisht i bashkuar dhe i pandarë. Ndarja e tij në Veri dhe Jug është thjesht një fabrikim i diplomacisë së huaj që ndodhi në fillim të shekullit tonë me dhënien e padrejtë dhe me dhunë të pjesës veriore shtetit atëherë të ri shqiptar.”

Mëtimet për karakterin helen të Epirit grekët i mbështetin në mitet për prejardhjen greke të familjeve mbretërore të Epirit, apo në interpretime të shtrembëruara të shkrimeve të autorëve të lashtë.

Kurse termi Vorio Epir (Epir i Veriut) është shumë i vonë. Ai ka lindur më 1913 kur Protokollli i Firences njohu kufijtë e sotëm të Shqipërisë për territoret e Shqipërisë së Jugut, përkundër mëtimeve të Greqisë, që donte tokat shqiptare në jug të vijës Llogara–Tepelenë–Këlcyre–Pogradec, të pushtuara prej saj gjatë Luftërave Ballkanike. Pikërisht, tokat shqiptare të Epirit antik që nuk u morën dot prej saj, u quajtën me emrin Vorio Epir. Megjithatë, shpesh edhe këtij i jepet një shtrirje edhe më e madhe. Kështu, në uebsajtin e përmendur më sipër thuhet: “Etnologjikisht, Epiri i Veriut shtrihet midis lumit të Shkumbinit dhe kufirit të sotëm të Shqipërisë me Greqinë... Zakonet dhe morali i popullit të tij, legjendat dhe traditat, këngët dhe vallet, arti popullor dhe veshjet popullore, konstitucioni shpirtëror dhe besimet janë të gjitha greke dhe provojnë karakterin helen të banorëve të tij.”

Të gjitha këto nuk do të kishin ndonjë vlerë dhe nuk do t’ia vlente të merreshe me to, nëse do të gjendeshin vetëm në faqet e internetit të organizatave nacionaliste greke. Por është ndryshe kur këto pretendime mbështeten me “argumente historike” nga historianë me emër, të cilët, duke braktisur parimin bazë shkencor, të mishëruar në shprehjen e Platonit: “Mik i Sokratit, po më shumë jam mik i së vërtetës”, vijnë të mbështetin me argumente gjoja historike politikë ekspansioniste të Athinës.

Për këtë, mjafton të lexosh përmbledhjen e vëllimshme “Epiri – 4000 vjet histori dhe qytetërim grek” (Epirus – 4000 Years of Greek History and Civilization, Athens, 1997), në parathënien e të cilit historiani në zë M. Sakelariu si kufi verior të Epirit merr vijën nga mali Ivan në Akrokeraunet. Për të, Epiri dhe toka të tjera shqiptare kanë qenë djepi i Greqisë. Në pjesën e fundit të parathënies së këtij vëllimi ky autor shkruan: “Përgjithësisht, mund të thuhet se, që nga shek. XVII deri në Luftën Greke për Pavarësi, Epiri ka qenë një nga zonat më dinamike të Greqisë në shumë fusha... Megjithatë, territoret epirote u përfshinë në shtetin e ri grek më vonë dhe me faza... Më në fund, pjesa jugore e asaj që ka qenë historikisht Epiri iu rikthye Greqisë dhe banorët e tij grekë iu bashkuan trungut kryesor helen.” (Epirus..., p. 11).

Historiani tjetër grek M. Haxopoulos i quan pohimet e autorëve të lashtë për karakterin jogrek të Epirit si të habitshme, duke thënë se “çështja e karakterit grek të epirotëve të lashtë nuk do të ishte ngritur, po të mos qe shtruar nga vetë autorët e lashtë grekë, të cilët herë u janë referuar epirotëve si barbarë, dhe herë e kanë vendosur Epirin jashtë kufijve të Greqisë.” (Epirus..., f. 140) Pra, grekët e lashtësisë u kanë hapur telashe grekëve të rinj, të cilëve u duhet t’i korrigjojnë dhe t’i manipulojnë pohimet e tyre! Manipulimi i parë ka të bëjë me termin “barbarë”, që, sipas tyre, “mund t’u referohet kritereve thjesht kulturore”, dmth. është përdorur për të treguar prapambetjen kulturore të epirotëve (Epirus..., po aty).

Edhe ndonjë dijetar me një njohje të thellë të Epirit, si N. Hamondi, tek i cili mbështetet Saqelariu, duke folur për epokën e bronzit, shkruan: “Baseni i popujve greqishtfolës prej të cilit ndodhën disa dyndje drejt Greqisë ishin Maqedonia Perëndimore, Shqipëria e Mesme dhe

Epiri. Pikërisht aty, në kushtet e një ekonomie kryesisht pastorale, u praktikuan në periudhën e mesme helladike institucionet patriarkale dhe fisnore të popullit grek, dialektet dhe ritet e tyre, duke përfshirë edhe varrimin e heronjve në tuma.” (Epirus..., p. 36) Duke ua lënë historianëve çështjet historike, po marrim vetëm shpjegimin e historisë së formimit të dialekteve të greqishtes së vjetër, të cilat, sipas autorit, na qenkan formuar në territorin e Epirit dhe pastaj, me një rregull që çdo gjeneral do ta kishte pasur zili, qenkan bartur në Greqi. Ky është një shpjegim naiv, që bie në kundërshtim me historinë e vërtetë të dialekteve të greqishtes së vjetër.

Sa i përket cilësimit të epirotëve si barbarë prej autorëve të lashtë, Hamondi çuditërisht përpriqet ta interpretojë ndryshe këtë fjalë. Duke u nisur nga ajo që molosët dhe fiset e varura prej tyre i shkruanin vendimet në greqishte, ai arrin në përfundimin që “këto fise flitnin greqisht pikërisht në kohën kur Tuqididi i quante barbarë”. “Kjo pushon së qeni një paradoks, – vijon Hamondi, – nëse kuptojmë që kontrasti në termin *barbaros* nuk ishte gjuhësor, po kulturor.” (Epirus..., p. 60). Të dyja argumentet e Hamondit nuk qëndrojnë. Së pari, të nisesh nga gjuha e mbishkrimeve do të thotë që t’i quash grekë apo romakë edhe ilirët dhe popuj të tjerë të lashtësisë, pasi mbishkrimet e asaj kohe janë ose në greqishte, ose në latinishte. Së dyti, siç treguam më sipër, nuk është vetëm Tuqididi, po janë një varg autorësh të tjerë: Herodoti, që e quan Ambrakinë “qytetin më të largët të Greqisë”; Efori që thotë se “Akarnania është fillimi i Greqisë”; Straboni, sipas të cilit, në veri të “akarnanianëve grekë” ishin popuj jogrekë, barbarët epirotë; dhe, më në fund, Stefan Bizantini, që atamanët i quan ilirë.

Kundër tezës së historianëve të sotëm grekë dhe të Hamondit për karakterin helen të Epirit flet edhe një fakt tjetër i rëndësishëm: kolonitë greke në Epir, në Iliri, në Italinë e Jugut dhe Sicili, në brigjet jugore të Francës, në brigjet e Detit të Zi etj., si Arta, Butrinti, Orikumi, Apollonia, Epidamni (Durrësi), Tarantoja, Sirakuza, Marseja, Nisa etj., qytete që u themeluan nga banorë të shpërngulur prej viseve të ndryshme të Greqisë. Po të kishte qenë Epiri tokë helene, atëherë Arta, Butrinti, Orikumi e Thronioni (Kanina) etj. nuk do të quheshin koloni greke, ashtu si nuk janë të tilla Athina, Teba, Korinti etj.

Pikën kulmore këto mëtime e arrijnë në qëndrimet e përfaqësuesve më të lartë të politikës greke, si deklarimi i mësipërm i presidentit grek se komuniteti grek i Shqipërisë së Jugut njihet që nga lashtësia me emrin “epirotë”, që do të thotë se banorët e Shqipërisë së Jugut, pasardhësit e vërtetë të epirotëve, shpallen prej tij si grekë(!) Dhe një deklaratë e tillë lëshohet nga kreu i shtetit grek në kuvendin e një organizate ultranacionaliste, si Federata Pan-Epirote Greke, e cila në programin e saj ka aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Kjo tregon se Athina zyrtare dhe qarqet ultranacionaliste greke veprojnë në unison. Por ajo që të çudit më shumë, është se deklarata të tilla bëhen nga një vend anëtar i Bashkimit Europian, i cili udhëhiqet nga parimi i integritetit territorial të shteteve dhe i paprekshmërisë së kufijve.

Pseudoshkenca për Epirin nuk ka mbetur një produkt i vdekur, vetëm në libra. Ajo i jep argumente politikës, ajo i injektohet brezit të ri, ajo frymëzon organizatat ultranacionaliste, strategjinë ushtarake të shtetit grek, kishën greke etj. Kështu, në programet e shkollave të mesme të Greqisë, Qiproja, Maqedonia dhe Epiri i Veriut trajtohen si “probleme kombëtare të pazgjidhura të së shkuarës” (ndërkohë që tek ne, sipas një direktive të përtejdetit, janë rishikuar tekstet shkollorë të historisë për t’i spastruar nga gjërat që nxitin urrejtje etnike); në botime të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtisë Greke flitet për “kryengritjen greke dhe shpalljen e autonomisë së Epirit” (shih librin “The Struggle for Northern Epirus”, Athens, 2000); në shtypin grek arrihet deri aty sa Himara të quhet “zemra e Greqisë”, “atdheu i dashur”, “vendi ynë”. Dhe e gjithë kjo frymë shoviniste dhe urrejtjeje i mëkohet sistematikisht dhe përditë popullit grek, bijtë e të cilit stërviten duke kënduar: “ata janë shqiptarë, litarë do bëjmë me zorrët e tyre”.

Orekset nacionaliste të Greqisë të kujtojnë fabulën e bretkosës që donte të bëhej sa një deve. Sikur ëndrra e saj të përmbushej një ditë, Greqia do të ndodhej para një realiteti të ri: përfshirja e etnive të reja në kufijtë e shtetit grek do të ndryshonte raportet demografike midis etnive të këtij vendi dhe kjo, nga ana e vet, do të shpinte në një ridefinim të identitetit kombëtar të saj.

Qëndrimet shoviniste të fqinjës sonë të jugut nuk mund të mos ngjallin kundërshtimin dhe nacionalizmin e shqiptarëve, të cilët përkundrejt mëtimeve territoriale të Athinës zyrtare s'kanë si të rrinë duarkryq. Nëse grekët nuk ndruhen të kërkojnë atë që është e të tjerëve, atëherë a nuk kemi të drejtë ne shqiptarët të mbrojmë atë që është jona? Megjithatë, midis nesh dhe grekëve ka një ndryshim të madh: Greqia mbetet një shtet me barkun në Europë dhe kokën në Bizant, kurse Shqipëria është një vend me kokën në Europë. Ndryshe nga Greqia që punon për të ringjallur Perandorinë e Bizantit, ne shqiptarët besojmë dhe ëndërrojmë një Ballkan të hapur, si pjesë të Europës së Bashkuar, gjë që do të mundësojë komunikimin e pakicave, të ndara nga kufijtë e sotëm politikë, me trungun etnik amë dhe konkurrimin, pa trysni politike, të gjuhëve, të kulturave dhe të ekonomive tona.

Ideja e Europës së Bashkuar lindi nga përvojat e hidhura të dy luftërave botërore si një përpjekje për ta shpëtuar kontinentin e vjetër nga djajtë e nacionalizmit dhe konfliktet etnike që burojnë soje. Në një Europë pa kufij, problemet e pakicave dhe gjithë tensionet e krijuara nga padrejtësitë e historisë do të zgjidhen lehtë. Çdo shtet evropian që përpiqet të përmbushë ëndrrat shoviniste të së kaluarës, shkon kundër rrjedhës së historisë dhe duhet frenuar e izoluar sa pa kaluar në veprime që mund të krijojnë tensione midis shteteve dhe etnive. Pyetja jonë, që do të mbetet pa përgjigje, është: Pse Brukseli e bën veshin të shurdhër ndaj mëtimeve territoriale të Greqisë kundrejt fqinjëve? Nuk dëgjon apo nuk do të dijë se ç'bëhet në jug të Ballkanit? A do t'u thotë ndal Europa djajve shovinistë të gadishullit tonë apo do të vijojë t'i përkëdhelë ashtu si në të kaluarën?

Rami Memushaj